



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.6/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 24.06.2024 nga Q.L., avokate nga Ferizaj, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtarja Gjykatës Themelore në Ferizaj L.P., në bazë të nenit 3, 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 03.07.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e datës 24.06.2024 parashtruar nga Q.L., avokate nga Ferizaj, kundër L.P., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me pretendimin për shkelje disiplinore në çështjen civile të evidentuar në gjykatë me numër SMIL si: 2021:025311, për shkak se nuk konstatohet se kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj si autoritet kompetent, më 24.06.2024 përmes zyrës së pranimit në gjykatë, ka pranuar njoftimin e paraqitur nga Q.L., avokate nga Ferizaj (tutje ankuesi), lidhur me lëndën 2021:025311. Në përshkrimin e këtij njoftimi, ankuesi ka njoftuar autoritetin kompetent lidhur me zhvillimin e procedurës civile nga paditësi F.M. etj nga Ferizaj, kundër të paditurve J.B. dhe M.B. ish nga Ferizaj tani me adresa të panjohur të banimit. Sipas ankuesit gjykata duke vepruar sipas dispozitave ligjore të LPK-së, ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor e mbajtur me datë 12.06.2023, nga kjo seancë është nxjerrë vendimi

procedural përmes të cilit lënda është dërguar në Ministrinë përkatëse për veprime tjera procedurale. Pas kthimit të lëndës nga Ministria përkatëse është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm sipas propozimit të palës paditëse dhe pas caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm gjykata ka mbajtur seancën fillestare në të cilën është propozuar dëgjimi i dëshmitarëve emrat e të cilëve janë dorëzuar sipas parashtresës, dhe pas kësaj gjykata me datë 27.12.2023 ka caktuar seancën mirëpo gjykata e ka shtyrë këtë seancë me arsyetimin që prapë duhet të njoftohet Ministria përkatëse në mënyrë që të ftohen palët e paditura.

Ankuesi tutje ka theksuar se me datë 18.06.2024 kemi pranuar vendimin për ndërprerjen e kësaj procedure nga shkaku që gjykata e ka pasur të pamundur që ti siguroj adresat e palëve të paditura në këtë çështje civile për shkak të ngrirjes së raporteve në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Sipas këtij vendimi gjyqtarja e çështjes përkundër faktit që të paditurve u ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm dhe se janë mbajtur dy seanca gjyqësore, ku ka marrë pjesë përfaqësuesi i përkohshëm si dhe ka paraqitur edhe përgjigje në padi, ka ndërprerë nga arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktvendimit të datës 29.05.2024.

Ankuesi ka theksuar se duke qenë të befasuar nga ky vendim në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPK-së, përmes kësaj parashtrese e njoftojmë Kryetarin e Gjykatës lidhur me veprimet e gjyqtarës së çështjes, dhe se për këto veprime do ta njoftojmë edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës si autoritet i vetëm mbikëqyrës i punës së Gjykatave në Republikën e Kosovës, për faktin se mendojmë që me një vendim të tillë janë duke u shkelur të drejtat Kushtetuese të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta në pronë, dhe përtej shkeljeve kushtetuese, gjykata ka bërë edhe shkelje të dispozitave tjera ligjore, duke kërkuar që Kryetari i Gjykatës në bazë të kompetencave që posedon do të veproj me urgjencë lidhur me zgjidhjen e kësaj çështje dhe së bashku me këtë njoftim i ka bashkangjitur si prova Aktvendimin me numër 2021:025311 të datës 29.05.2024 si dhe ankesën e paraqitur ndaj këtij vendimi mbi ndërprerjen e procedurës, përkundër që gjykata shkallës së parë fare nuk ka lënë këshillë juridike, ne i jemi drejtuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si instancë më e lartë pasi që vlerësojmë se vendimi i tillë është në kundërshtim të plotë me normat ligjore.

Autoriteti kompetent përmes shënimit zyrtar të datës 26.06.2024 ka ftuar ankuesin për ta sqaruar njoftimin e paraqitur me datë 24.06.2024, duke kërkuar që e njëjta ta konkretizon parashtrësën e saj se a ka të bëjë vetëm me njoftim drejtuar kryetarit, apo kërkesa e saj është kërkesë për inicim të procedurë disiplinore ndaj gjyqtarës, dhe e njëjta ka theksuar se kjo parashtrësë ka qenë njoftim për Kryetarin e Gjykatës dhe për këtë është njoftuar edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe njëkohësisht ka kërkuar që ky njoftim të trajtohet edhe se ankesë disiplinore ndaj gjyqtarës.

Autoriteti kompetent, me datë 2 korrik 2024, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes e-mailit zyrtar ka pranuar njoftimin me shkrim drejtuar Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili njoftim në përmbajtje është i njëjtë me njoftimin që është dërguar Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Kryetari i Gjykatës, si autoritet kompetent pas pranimit të ankesës duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057 përmes shkesës ADGJTHFR.nr.6/24 të datës 27 qershor 2024 ka njoftuar Këshillin Gjyqësorë të Kosovës lidhur me regjistrimin e ankesës së parashtruar nga Q.L., avokate nga Ferizaj.

Duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës si autoriteti kompetentë po me datë 27 qershor 2024 ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja ndaj të cilit është parashtruar ankesa, e cila në deklaratën e saj datë 28.06.2024, ka përshkruar kronologjinë e veprimeve në këtë çështje. Gjyqtarja ka theksuar se paditësi F.M., nga Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson avokatja Q.L., ndaj të paditurve J.B. nga Ferizaj, tani me adresë të panjohur ka deponuar padi për vërtetimin e pronësisë me datë 10.02.2021. Gjykata me dt. 12.06.2023, e ka mbajtur seancën e parë përgatitore për këtë çështje, në të cilën ka përmendur se mbetet në tërësi pranë thënieve në kërkesë padinë e deponuar, deri sa pasi të paditurin nuk e kanë gjetur për tu paraqitur në seancë, përfaqësuesja e paditësit i ka propozuar gjykatës që të paditurit ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, në pajtim me nenin 79 pika 3 nën par. a) i LPK, pas kësaj gjykata ka sjellë Aktvendim ku ka përmendur se pasi të paditurit nuk i kanë gjetur në adresë, që sipas propozimit të paditësit, Gjykata më vonë tua caktoj të paditurve përfaqësuesin e përkohshëm, dhe që përmes Ministrisë të Drejtësisë, përmes degës për bashkëpunim ndërkombëtar, do të tentoj që ti gjej të paditurit në cilin shtet gjinden.

Gjyqtarja ka deklaruar se Gjykata me datë 30.10.2023, ka lëshuar Aktvendim në të cilin për përfaqësues të përkohshëm të paditurve e ka caktuar avokatin J.R. nga Ferizaj, i cili në emër të paditurve do ta udhëheqë këtë kontest, deri në paraqitjen e tyre në kontest dhe njëherit e ka obliguar përfaqësuesin e përkohshëm që ti ndërmerr të gjitha veprimet duke përfshirë edhe kontaktin direkt me Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës, që përmes tyre të kërkoj nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë, që ti gjej të paditurit, se ku ndodhen ata në Republikën e Serbisë, dhe që pas kësaj që ti sjell në kontest, për përfundimin e këtij kontesti. Gjykata me dt.05.12.2023, në seancën e dytë përgatitore të mbajtur ka kërkuar, deklarin e palëve, lidhur me këtë çështje. Në këtë seancë përfaqësuesja e paditësit ka potencuar se mbesin në tërësi pranë kërkesë padisë, deri sa përfaqësuesi i përkohshëm ka deklaruar, se momentalisht e konteston kërkesë padinë e paditësve, nga shkak se nuk është e furnizuar me prova dhe fakte të mjaftueshme për të pasur sukses të ketë pamje në gjendjen faktike të kontestit dhe se pas shikimit të shkesave të lëndës do të deklarohet lidhur me thëniet paditëse të, paditësit.

Po ashtu gjyqtarja ka deklaruar se me dt. 27.12.2023, në seancën e tretë përgatitore, ka gjetur se bëhet fjalë për seancë kryesore, për këtë çështje pas dëgjimit të palëve, dhe deklaratës së përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve, ka gjetur se është e pamundur të gjenden të paditurit, pasi marrëdhëniet në mes të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Serbisë dhe të Kosovës, momentalisht janë të ngrira dhe se afati prej 6 muajsh pas dërgimit të kërkesës Ministrisë ka skaduar. Gjykata në pajim me nenin 277 par.1 i LPK ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke marrë parasysh se të paditurit përkundër se janë ftuarit me gjyqësor të rregullt nuk janë paraqitur në seancë, e as që gjykata përmes Ministrisë të Drejtësisë të Kosovës, ka arritur të gjej të paditurit. Gjykata e solli aktvendimin mbi ndërprerjen e procedurës. Udhëzimin mbi këshillën juridike neni 281.1 Ankesa kundër aktvendimit në të cilën konstatohet (neni. 277) apo caktohet (neni. 278) pezullimi i procedurës nuk e pengon ekzekutimin e aktvendimit. Gjykata do të sjell aktvendim mbi korrigjimin e aktvendimit me të drejtën në ankesë.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtares së rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese por edhe shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtares L.P.

Me aktvendimin nr.smil 2021:025311 të datës 12.04.2024, gjyqtarja e çështjes L.P., ka ndërprerë procedurën në këtë kontest për shkak të pamundësisë së gjetjes së të paditurve¹.

Autoriteti kompetent duke vlerësuar pretendimet ankimore për shkelje disiplinore të përshkuara nga ankuesi, e të cilat kanë të bëjmë me zbatimin e procedurës nga ana gjyqtare në lidhje me nxjerrjen e vendimit 2021:025311 të datës 12.04.2024 mbi ndërprerjen e procedurës, i cili aktvendim sipas ankuesit është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPK-së, por edhe në kundërshtim me të drejtat kushtetuese, vlerëson se nuk është kompetent dhe nuk ka të drejtën e komentimit të vendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari i çështjes sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësiive të tyre si gjyqtarë”.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate rikujton parashtruesin e ankesës se aplikimi i gabuar i të drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur qoftë ndaj aktvendimit ndaj të cilit lejohet ankesa qoftë ndaj aktgjykimit, por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Për më tepër nga shkresat e lëndës rezulton se ndaj aktvendimit 2021:025311 të datës 25.05.2024 parashtruesi ka paraqitur ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj 2021:025311 të datës 25.05.2024 mbi ndërprerjen e procedurës kontestimore, dhe është Gjykata e Apelit e Kosovës që e vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shkeljet e dispozitave të drejtës materiale apo atyre procedurale.²

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën

¹ Shih aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj 2021:025311 datë 12.04.2024

² Ankesa e paraqitur nga e autorizuar e paditësit, av.Q.L., kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj 2021:025311, mbi ndërprerjen e procedurës.

Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.6/24, datë 03.07.2024

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Q.L., avokate nga Ferizaj, Parashtrues i ankesës

L.P., Gjyqtare

Këshillit Gjyqësor të Kosovës